

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Tërheqja / *el-Kabd* / الْقَبْضُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"ثُمَّ قَبْضَنَا إِلَىٰ قَبْضًا يَسِيرًا"

"Pastaj Ne e tërheqim atë te Ne me një tërheqje të lehtë (graduale)." (el-Furkaan, 46)¹

Tërheqja në këtë kaptinë i referohet stacionit ose shkallës së të çmuarve (*denaa'in*)², të cilët i Vërteti i kurseu për Vetën e Tij³. Këta ndahen në tri grupe:

Një grup të cilët Ai, me qëllim që t'i mbrojë, i tërhoqi drejt Vetes së Tij duke i kursyer kështu nga sytë e njerëzve⁴.

¹ Ajeti flet për hijen dhe mënyrën sesi Allahu e zgjat e pastaj e tërheq. Pra, fjala '*kabd*', që përdoret për kapje/ngushtim/kufizim, këtu na paraqitet në këtë kontekst (të tërheqjes).

² Fjala arabe '*denaa'in*' do të thotë diçka tepër e çmueshme për t'u ndarë me të tjerët.

³ Ibn el-Kajjim thekson në *Medaarixh* se *kabd* në këtë kaptinë nuk është *kabd* i fillsave ku Allahu u shkaktonte njerëzve shqetësim (ngushtim në gjokse), kur ata mëkatojnë, në mënyrë që t'i thërrasë për pendim ose, kur ata shpërqendrohen, në mënyrë që t'i shpëtojnë nga shkuajdesja. Ky *kabd* i përket seksionit të realiteteve, prandaj dhe përbën një shkallë shumë më të lartë. Këta janë njerëz të cilët Allahu i konsideron tepër të çmuar për t'i ndarë me ndokënd. Ai i pengon zemrat e tyre për çdo gjë tjetër përveç Zotit, kështu që ata bëhen vetëm të Tijët.

⁴ Këta janë personat që vetmohen dhe rrinë larg njerëzve. Kjo do të ishte një shkallë ose stacion i pëlqyer gjatë fitneve (çrregullimeve) të mëdha, si ato nga fundi i kohës. Pejgamberi (alejhi selam) tha:

Një grup të cilët Ai i tërhoqi drejt Vetes së Tij duke i mbuluar me rrobën e ngatërrimit⁵ dhe i mbështolli me forma⁶. Kësisoj Ai i fshehu nga sytë e njerëzve⁷.

Një grup të cilët Ai i tërhoqi drejt Vetes së Tij duke i sjell fshehurazi në shoqërimin intim me Të dhe duke i kursyer nga vetët e tyre⁸.

“Së shpejti do të vijë një kohë kur prona më e mirë e një muslimani do të jenë delet që ai merr me vete në majë të maleve dhe në luginat e plleshme, me qëllim që të ikën me fenë e vet nga çrregullimet (sprovat).” (el-Buhari)

⁵ Njerëzit i shohin këta ewlija të përzihen me ta sikurse njerëzit e rëndomtë, por megjithëkëtë këta janë të ndryshëm, prandaj dhe njerëzit ngatërrohen lidhur me realitetin e tyre.

⁶ Format dhe dukuritë e rëndomta të jetës që shumica e njerëzve i kanë të përbashkëta. Domethënë, ata shkojnë në punë, martohen, bëjnë fëmijë, ecin nëpër tregje, vishen me tesha të zakonshme, etj.

⁷ Me anë të paraqitjes së tyre të rëndomtë, jo me anë të veçimit ose të izolimit nga të tjerët. Pejgamberi (alejhi selam) tha:

“Besimtari i cili përzihet me njerëz dhe duron dëmin e tyre, do të ketë shpërblim më të madh sesa besimtari i cili nuk përzihet me njerëz dhe nuk duron dëmin e tyre.” (Ibn Maxheh)

⁸ Këta jo vetëm që nuk u kushtojnë vëmendje njerëzve, por frikë-respekti që kanë ndaj Zotit i bën të pavëmendshëm edhe ndaj vetëve të tyre, kështu që nuk i shohin si të vetat veprat që i bëjnë dhe as nuk shohin ndonjë administrim nga ana e tyre të mirësive që bëjnë, por vetëm të Tijin.